

Procesverbal - Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Shërbim GPS për mjetet”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sisteme GPS ose te ngjashme 38112100-4

Vlera e fondit limi: 3.459.333 (tre milion e katerqind e pesedhjetë e nente mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht në 69.186,6 (gjashtëdhjetë e nente mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje gjashtë).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 43, pika 1, pika 2 c) neni 55 pika 4, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,

ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 .Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin se ka të punësuar punonjës të diplomuar në njërin nga fushat: Inxhinieri Elektronike ose Inxhinieri Informatike ose Teknologji Informatike, ose Informatike ose Informatike Ekonomike .

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat përkatëse , kontratat e punës (të vlefshme).

Punonjesit e mësipërm duhet të kenë njohuri/kualifikime sipas kërkesave të mëposhtme:

a) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës teknik të certifikuar si Menaxher Projekti në fushën e menaxhimit të projekteve. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse.

Në rast se çertifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ta paraqesë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

b) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të çertifikuar për implementimin Databaze Oracle ose ekuivalente. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse. Në rast se çertifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ta paraqesë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

c) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në siguri dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tipit SERVER ose ekuivalente. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse.

Në rast se çertifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ta paraqesë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

d) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si **MCAD** Microsoft Certified Application Developer për Microsoft NET ose ekuivalente . Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse.

Në rast se çertifikata është në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ta paraqesë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Një punonjës mund të posedojë më shumë se një certifikim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për punonjësit e sipërcituar dokumentacionin e mëposhtëm:

a. Çertifikatat përkatëse. Në rast se çertifikatat janë në gjuhë të huaj operatori ekonomik duhet ti paraqesë të përkthyer sipas dispozitave ligjore në fuqi.

b. Listëpagesën e 3 muajve të fundit.

c. Diplomën përkatëse

d. Kontratë pune të vlefshme

e. Vërtetimin për numrin e punonjësve të siguruar për 3 muajt e fundit të lëshuar nga administrata tatimore.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Vendosja e kriterit në gërmën a) është vendosur për arsye se shërben për hartimin e planit të zbatimit dhe implementimit të sistemit nga çdo pajisje si dhe drejton punën dhe jep rrugëzgjdhje për çdo problematikë të hasur gjatë rrugës.

Lidhur me punonjësin e kërkuar në pikën 2.4 gërma b) të DST-së do të bëjë të mundur mirëmbajtjen e databazës me të dhënat e secilit automjet, lëvizjeve të tij, shpejtësisë, sasisë të karburantit etj si dhe do të nxjerrë cdo raport nga databaza në varësi të kërkesave specifike nga AK.

Në pikën 2.4. gërma c) Autoriteti Kontraktor gjykon se sistemi i implementuar kërkon 1 specialist për mirëmbajtjen e pajisjes Server ku do të ruhen dhe depozitohen të gjitha të dhënat dhe log-et e krijuara gjatë procesit të punës. Gjithashtu ky specialist do të kujdeset për sigurinë e kësaj pajisje nga ndërhyrje të paautorizuara.

Lidhur me punonjësin e kërkuar në pikën 2.5 gërma c) referuar specifikimeve teknike është përcaktuar që ky sistem i kërkuar do të përshtatet edhe për përdorim në telefonin e lëvizshëm mobile në trajtën e një aplikacioni dhe për rrjedhojë është e nevojshme 1 person i certifikuar **MCAD** ose ekuivalente për realizimin e këtij qëllimi.

2.3.3.Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë(e vlefshme)lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

2.3.4.Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO/IEC 27001-2013 (e vlefshme) (për Sigurinë e Informacionit) ose e përditësuar lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.(Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili

operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 27001:2013 :Njohja është një nga vlerat më të rëndësishme të një organizate në sigurimin e vazhdimësisë së biznesit.Në rast se shumë pasuri janë humbur, informacioni i humbur nuk ka ekuivalent monetar. Për këtë arsye, në kushtet që ndryshojnë dhe zhvillohen sot, rëndësia e informacionit dhe domosdoshmëria e mbrojtjes po rritet gradualisht. informacionit; Ajo mund të përdoret dhe të ruhet me shkrim, media elektronike, verbale, kujtesa e punonjësve dhe shumë formate të tjera. Për shkak të përparimeve teknologjike, shumë prej këtyre formave të përdorimit mund ose nuk mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Për shkak të këtij ndryshimi dhe zhvillimi, siguria e informacionit duhet të pyetet vazhdimisht dhe kontrollohet. Siguria e informacionit është mbrojtja e konfidencialitetit, integritetit dhe përdorshmërisë së informacionit. ISO 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit është një sistem menaxhimi që përfshin njerëzit, proceset dhe sistemet e informacionit në sigurimin e informacionit të korporatave të informacionit dhe mbështetet nga menaxhmenti i lartë. Është hartuar për të mbrojtur asetet e informacionit dhe për të siguruar kontrolle adekuate dhe proporcionale të sigurisë që i japin besim palëve të interesuara. Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO 27001 përfshin strukturën e korporatave, politikat, aktivitetet e planifikimit, përgjegjësitë, aplikacionet, procedurat, proceset dhe burimet.

II. ARGUMENTIM

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në funksion të sigurimit të një sistemi të integruar për monitorimin, menaxhimin dhe kontrollin në kohë reale të flotës së automjeteve të Autoritetit Kontraktor. Këto specifikime nuk janë përcaktuar për të favorizuar një prodhues apo markë të caktuar, por janë bazuar në parametrat minimalë teknikë që garantojnë funksionimin e qëndrueshëm, sigurinë, besueshmërinë dhe performancën e sistemit gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Objekti i kontratës nuk konsiston vetëm në furnizimin me pajisje GPS, por në ofrimin e një zgjidhjeje të plotë që përfshin pajisjet, programin e monitorimit, komunikimin celular, hostimin, mirëmbajtjen, asistencën teknike dhe trajnimin e përdoruesve.

Argumentimi i specifikimeve teknike të pajisjes GPS

Specifikimi që pajisja të mbështesë teknologjitë **GSM/GPRS/GNSS/Bluetooth** është vendosur për të garantuar transmetimin e pandërprerë të të dhënave, lokalizimin satelitor dhe komunikimin me aksesoret shtesë, duke rritur fleksibilitetin e sistemit.

Kërkesa për mbështetjen e sistemeve satelitore **GPS, GLONASS, GALILEO, BEIDOU, QZSS, AGPS, SBAS dhe DGPS** është vendosur për të siguruar saktësi më të lartë të pozicionimit dhe vazhdimësi të sinjalit edhe në ambiente urbane me ndërtesa të larta, zona malore ose kushte të vështira atmosferike.

Numri minimal prej **33 kanaleve marrëse** garanton marrjen simultane të sinjaleve nga disa sisteme satelitore, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e lokalizimit.

Sensitiviteti i gjurmimit jo më pak se **-165 dBm** është kërkuar për të siguruar funksionimin e pajisjes edhe në zona me mbulim të dobët satelitor, si tunele të shkurtra, garazhe apo zona urbane të dendura.

Gabimi maksimal i pozicionimit **2.5 m CEP** është kërkuar për të garantuar identifikimin e saktë të vendndodhjes së automjeteve dhe eliminimin e devijimeve gjatë raportimit.

Mbështetja e **Bluetooth 4.0 Low Energy** mundëson komunikimin me sensorë shtesë duke ruajtur konsum minimal të energjisë.

Temperatura operative nga **-40°C deri në +85°C** siguron funksionimin normal të pajisjeve në të gjitha kushtet klimatike ku operojnë automjetet e Autoritetit Kontraktor.

Bateria e brendshme minimale **400 mAh** është kërkuar për të garantuar transmetimin e pozicionit edhe në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike të automjetit.

Gabimi maksimal i matjes së shpejtësisë më i vogël se **0.1 m/s** mundëson raportim të saktë të mënyrës së drejtimit të automjeteve.

Përdorimi i modulit GSM dhe frekuencave **Quad Band 850/900/1800/1900 MHz** garanton kompatibilitet me rrjetet celulare ekzistuese.

Kërkesa për hyrje dhe dalje dixhitale dhe analoge është vendosur për të lejuar lidhjen e sensorëve të ndryshëm si kontrolli i ndezjes së motorit, sensorët e karburantit, alarmet dhe pajisje të tjera monitorimi.

Komunikimi përmes **USB 2.0 Micro USB** mundëson konfigurimin dhe mirëmbajtjen e lehtë të pajisjes.

Memoria e brendshme **128 MB** garanton ruajtjen lokale të të dhënave në rast të mungesës së sinjalit GSM dhe transmetimin automatik sapo lidhja të rikthehet.

Identifikimi i ndezjes së motorit nëpërmjet hyrjes dixhitale ose akselerometrit mundëson evidentimin automatik të fillimit dhe përfundimit të udhëtimeve.

Certifikimet **CE/RED, E-Mark, EAC, RoHS dhe REACH** garantojnë përputhshmërinë e pajisjeve me standardet ndërkombëtare të sigurisë, kompatibilitetit elektromagnetik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Furnizimi me tension **6–30 V** dhe mbrojtja nga mbingarkesat elektrike sigurojnë përdorimin e pajisjes në automjete me sisteme elektrike të ndryshme.

Argumentimi i specifikimeve teknike të sistemit software

Kërkesa që sistemi të mundësojë monitorimin në kohë reale me interval gjurmimi çdo **5 sekonda** është vendosur për të garantuar kontroll të vazhdueshëm të flotës dhe reagim të shpejtë në situata operative.

Informacioni mbi pozicionin, shpejtësinë, gjendjen e motorit, adresën, baterinë, tensionin, përshpejtimin dhe frenimin mundëson kontroll të plotë të përdorimit të automjeteve dhe analizimin e sjelljes së drejtuesve.

Raportet mbi kilometrat, kohën e punës, ndalesat, shpejtësitë, përdorimin gjatë ditëve të punës dhe pushimit, si dhe hyrje-daljet në zona të caktuara, janë të domosdoshme për administrimin racional të flotës, kontrollin e konsumit të karburantit dhe evidentimin e përdorimit jashtë destinacionit.

Eksportimi i raporteve në **PDF** dhe **Excel** lehtëson analizën, arkivimin dhe integrimin me dokumentacionin administrativ.

Gjenerimi automatik dhe dërgimi i raporteve me email automatizon proceset e monitorimit dhe redukton ndërhyrjet manuale.

Ruajtja e të dhënave deri në përfundimin e kontratës dhe për **6 muaj pas saj** garanton vazhdimësinë e informacionit dhe mundësinë e konsultimit edhe pas përfundimit të marrëdhënies kontraktore.

Monitorimi i nivelit të karburantit mundëson kontroll më të mirë të konsumit dhe evidentimin e rasteve të mundshme të abuzimit, për aq sa automjeti e lejon teknikisht.

Asistenca teknike brenda **24 orëve**, zëvendësimi i pajisjeve në garanci dhe suporti i vazhdueshëm janë kërkuar për të minimizuar ndërprerjen e funksionimit të sistemit.

Trajnimi i stafit të Autoritetit Kontraktor garanton përdorimin korrekt të platformës dhe shfrytëzimin maksimal të funksionaliteteve të saj.

Hostimi pa pagesë shtesë, operatori telefonik, hapësira në server dhe garancia njëvjeçare janë pjesë integrale e shërbimit dhe shmangin kostot shtesë gjatë zbatimit të kontratës.

Sistemi kërkohet të jetë plotësisht **Web Based**, i aksesueshëm nga kompjuteri dhe pajisjet mobile, pa pasur nevojë për instalime lokale, duke mundësuar përdorimin nga çdo vend me lidhje interneti.

Mbështetja e hartave **Google, ESRI** dhe hartave të tjera siguron fleksibilitet në vizualizimin e të dhënave dhe saktësi më të lartë gjeografike.

Përdorimi i gjuhës shqipe lehtëson përdorimin nga personeli i Autoritetit Kontraktor dhe redukton nevojën për trajnim shtesë.

Funksionalitetet si dashboard-et analitike, raportet **Business Intelligence**, grupimi i mjeteve, njoftimet automatike për alarme, probleme me alternatorin, hyrje-daljet në zona të caktuara (Geofencing), ruajtja e shënimeve dhe shpërndarja automatike e vendndodhjes përmes link-ut janë kërkuar për të përmirësuar procesin e monitorimit, analizës dhe vendimmarrjes menaxheriale.

Kërkesa që sistemi të jetë kompatibël me shfletues të ndryshëm interneti garanton përdorim të lehtë pa kufizime teknologjike dhe pa nevojën e instalimit të aplikacioneve të dedikuara.

Të gjitha specifikimet teknike të mësipërme përfaqësojnë **kërkesa minimale funksionale dhe teknike**, të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës. Ato janë hartuar në mënyrë proporcionale me nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, duke lejuar pjesëmarrjen e çdo operatori ekonomik që ofron pajisje dhe sisteme me karakteristika teknike ekuivalente ose më të mira.